



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e Senatit
Prof. dr. Nurten Deva

Nr. Prot. 2139 Dt 16.09.2026

Në bazë të nenit 48 dhe nenit 49, të Statutit të Universitetit, Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2026, mori:

VENDIM

- I. Zgjatet afati për aplikim dhe regjistrim të studentëve për nivelin Bachelor dhe Master në UIBM për 2 (ditë) shtesë prej datës së fundit të paraqitur në konkurs, për shkak të problemeve teknike të paraqitura me Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU).
- II. Afati i aplikimi në nivelin Bachelor zgjatet deri me 22.09.2026, ndërsa për nivelin Master deri me 21.09.2026, rrjedhimisht datat e procesit ndryshohen në vijim:
 - Provimi pranues për nivelin Bachelor mbahet më 23.09.2026, nga ora 10:00.
 - Provimi pranues për nivelin Master mbahet më 23.09.2026 nga ora 11:00.
 - Shpallja e rezultateve preliminare bëhet më 23.09.2026 në web faqe të UIBM.
 - Afati për ankesat nga momenti i shpalljes të rezultateve preliminare është deri më 25.09.2026, ora 15:00.
 - Shpallja e rezultateve përfundimtare pas shqyrtimit të ankesave përkatësisht me datë 28.09.2026.
 - Regjistrimi, fotografimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet prej 29.09.2026 deri më 01.10.2026, prej orës 9:00 – 15:00.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Senati i Universitetit, duke pasur parasysh se gjatë procesit të aplikimit janë shfaqur vështirësi teknike të lidhura me funksionimin e sistemit të menaxhimit universitar, ka vlerësuar se është e nevojshme të zgjatet afati për aplikim dhe regjistrim në nivelin Bachelor dhe Master. Ky vendim është marrë për të garantuar qasje të barabartë për të gjithë kandidatët dhe mbarëvajtjen e procesit në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e brendshme të Universitetit.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM-së;
2. Menaxhmentit të UIBM;
3. Fakulteteve;
4. Zyrës për shërbim të studentëve;
5. Zyrës për IT;
6. Zyrës për informim me publikun;

